



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
REKTORATI

Nr. 1200 Prot

Gjirokastrë, më 22/10/2021

**Lënda:** Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me Universitetin e Molises, Itali.

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti i Molises, Itali, ka fituar një grant për kërkim shkencor dhe trajnim në bashkëpunim me Universitetin e Gjirokastrës.

Nën këtë grant nga Universiteti i Molises do të financohen mobilitetet në fushën e **Turizmit (Departamenti i Politikave Ekonomike dhe Turizmit, Departamenti i Historisë dhe Gjeografisë)** si më poshtë:

- **5 pozicione për studentë** (Cikli i I dhe II i studimeve) për të ndjekur 1 semester (25 muaj në total) në kurset Bachelor dhe Master në Turizëm.
- **2 pozicione staf akademik** për mësimdhënie për 12 ditë në total (6 ditë+6 ditë).
- **1 pozicion për staf akademik** për trajnim për 6 ditë.

Planifikimi i aktivitetit mësimor/ mësimdhënës/ mësimnxënës do të zhvillohet gjatë vitit akademik **2021-2022**, semestri i dytë. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht në nivelin B1 për studentët dhe B2 për stafin për mësimdhënie dhe trajnim.

Ftohen gjithë të interesuarit, të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **15.11.2021**:

- një letër interesi, në shqip dhe anglisht që përshkruan ciklin e leksioneve që mendoni të zhvilloni në Universitetin e Molises.
- një CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS CV në shqip dhe në anglisht.
- një provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze sipas niveleve të specifikuara më sipër.

Dokumentacioni do të shqyrtohet nga autoriteti përkatës dhe më pas vlerësimi përfundimtar do t'u bëhet me dije aplikantëve.

Prof. dr. Bektash Mema

REKTOR

